



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8891, DATË 2.5.2002 “PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONEVE HETIMORE TË KUVENDIT”**

Në mbështetje të neneve 77 pika 3, 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 dhe 2 të Kushtetutës,
me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve
Hetimore të Kuvendit”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Fjala e dytë e nenit 12 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Prania e personave të tjerë në mbledhjet e komisionit vendoset me vendim të
Komisionit.”.

Neni 2

Neni 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 13

Marrja e vendimeve

1. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë së paku të gjithë anëtarët që i takojnë grupimit politik ku bëjnë pjesë nismëtarët e komisionit.
2. Komisioni merr vendime me shumicën e të gjithë anëtarëve të pranishëm.
3. Komisioni voton zakonisht me ngritjen e dorës, përveç rastit kur me kërkesën e të paktën tre anëtarëve kërkohet që votimi të bëhet nominal ose i fshehtë.
4. Kërkesa për hetime ose marrje provash nga çdo anëtar i komisionit pranohet nga komisioni pa votim.”.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më ____/____/2016.

KRYETARI

ILIR META